



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

V E N D I M

Nr. 2497, datë 08.09.2014

Për

“Shqyrtimin e ankimit administrativ të ABCOM sh.p.k., SIN-TEL sh.p.k, TELE.Co Albania sh.p.k, SABATEL sh.p.k., dhe NISATEL sh.p.k, ndaj Vendimit të AKEP nr. 2489, datë 26.6.2014, “Për disa ndyshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit të Altelecom sh.a. në lidhje me thirrjet drejt numrave të portuar në rrejtet fikse””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Antëtare
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 08.09.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimin e ankimit administrativ të ABCOM sh.p.k., SIN-TEL sh.p.k, TELE.Co Albania sh.p.k, SABATEL sh.p.k., dhe NISATEL sh.p.k, ndaj Vendimit të AKEP nr. 2489, datë 26.6.2014, “Për disa ndyshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit të Altelecom sh.a. në lidhje me thirrjet drejt numrave të portuar në rrejtet fikse”

BAZA LIGJORE:

1. Ligji nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**Ligji nr. 9918**);

2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 19, datë 14.6.2010 “Për aksesin dhe interkoneksionin” e ndryshuar;
4. Rregullore nr. 13, datë 16.4.2010 “Për portabilitetin e numrit” e ndryshuar;
5. Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP, nr. 2176-2179, datë 29.10.2012, për miratimin e ofertave referencë të interkoneksionit të operatorëve celularë;
6. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr.2403, datë 26.12.2013, për miratimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit të sipërmarrësit Altelecom sh.a (për rrjetin telefonik fiks).
7. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr. 2489, datë 26.6.2014, “Për disa ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit të Altelecom sh.a. në lidhje me thirrjet drejt numrave të portuar në rrjetet fikse”

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e **Abcom** sh.p.k. e datës 22.7.2014 (*nr. 1817Prot.i AKEP, datë 25.7.2014*) Abcom sh.p.k., me anë të së cilës ka paraqitur ankim ndaj Vendimit nr. 2489, datë 26.6.2014 të AKEP, “Për disa ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit të Altelecom sh.a, në lidhje me thirrjet drejt numrave të portuar në rrjetet fikse, të miratuar nga AKEP me VKD nr.2403, datë 26.12.2013.”;
- Shkresa e **Sintel** sh.p.k e datës 23.07.2014 (*nr. 1816Prot.i AKEP, datë 25.7.2014*), me anë të së cilës ka paraqitur ankim ndaj Vendimit nr. 2489, datë 26.6.2014 të AKEP, “Për disa ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit të Altelecom sh.a, në lidhje me thirrjet drejt numrave të portuar në rrjetet fikse, të miratuar nga AKEP me VKD nr.2403, datë 26.12.2013.”;
- Shkresa e **Tele.Co Albania** sh.p.k e datës 23.07.2014 (*nr. 1828Prot.i AKEP, datë 25.7.2014*), me anë të së cilës ka paraqitur ankim ndaj Vendimit nr. 2489, datë 26.6.2014 të AKEP, “Për disa ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit të Altelecom sh.a, në lidhje me thirrjet drejt numrave të portuar në rrjetet fikse, të miratuar nga AKEP me VKD nr.2403, datë 26.12.2013.”;
- Shkresa e **Nisatel** sh.p.k e datës 16.07.2014 (*nr. 1836Prot.i AKEP, datë 29.7.2014*), me anë të së cilës ka paraqitur ankim ndaj Vendimit nr. 2489, datë 26.6.2014 të AKEP, “Për disa ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit të Altelecom sh.a, në lidhje me thirrjet drejt numrave të portuar në rrjetet fikse, të miratuar nga AKEP me VKD nr.2403, datë 26.12.2013.”, dhe
- Shkresa e **Sabatel** sh.p.k e datës 23.07.2014 (*nr. 1837Prot.i AKEP, datë 29.7.2014*), me anë të së cilës ka paraqitur ankim ndaj Vendimit nr. 2489, datë 26.6.2014 të

Adresa: Rr. “Abdi Toptani”,
Godina Torre Drin, Kati IX, Tiranë

Tel : + 355 4 2259 571
Fax : + 355 4 2259 106

www.akep.al
info@akep.al

AKEP, “Për disa ndyshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit të Altelecom sh.a, në lidhje me thirrjet drejt numrave të portuar në rrjetet fikse, të miratuar nga AKEP me VKD nr.2403, datë 26.12.2013.”.

- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**), si dhe duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I. Sipërmarrësit e tregut të komunikimeve elektronike ABCOM sh.p.k., SINTEL sh.p.k, TELE.Co Albania sh.p.k, SABATEL sh.p.k., dhe NISATEL sh.p.k, kanë investuar shqyrtimin administrativ të AKEP nëpërmjet depozitimit të ankimeve administrative individuale por me objekt dhe përmbajtje të njëjtë në thelb ndaj Vendimit nr. 2489, datë 26.6.2014 të AKEP, “Për disa ndyshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit të Altelecom sh.a, në lidhje me thirrjet drejt numrave të portuar në rrjetet fikse, të miratuar nga AKEP me VKD nr.2403, datë 26.12.2013.”.

Sipërmarrësit, në parashtrimet e tyre duke arsyetuar objektin ankimor për aktin administrative të nxjerrë nga AKEP , kanë kërkuar shfuqizimin e pikës 1./a, nënpika ‘c’ dhe pikës 1/b, nënpika ‘c’ të Vendimit nr. 2489, datë 26.6.2014.

- Sipas tyre, në lidhje me:

- shfuqizimin e pikës 1/a, nënpika ‘c’ e cila parashikon që “...*thirrje të origjinuara nga rrjete ndërkombëtare, të përcjella me interkoneksion direkt tek Operatorit Përfitues me bartës ndërkombëtarë (jo i autorizuar nga AKEP), drejt numrave të Operatorit Përfitues të portuar në rrjetin e Altelecom...*”.

Tarifa, edhe për këtë trafik të terminuar në rrjetin e Altelecom sh.a., është e njëjtë me tarifën përkatëse të terminimit të thirrjeve kombëtare.

- shfuqizimin e pikës 1/b, nënpika ‘c’ e cila parashikon që “... *thirrje të origjinuara nga rrjete ndërkombëtare, të përcjella me interkoneksion direkt tek Altelecom me bartës ndërkombëtare (jo i autorizuar nga AKEP), drejt numrave të Altelecom të portuar në rrjetin e Operatorit Përfitues*”.

Tarifa, edhe për këtë trafik të terminuar në rrjetin e operatorit përfitues, është e njëjtë me tarifën përkatëse të terminimit të thirrjeve kombëtare.

- Në ankesat e tyre, ndër kryesoret është shpjeguar se:

1. Duke iu referuar pjesës arsyetuese të Vendimit të AKEP, pikës V, 6, gërma a, argumentohet se, në treg nuk ndodh që, tarifa për terminimin e thirrjeve hyrëse

- ndërkombëtare që aplikojnë operatorët alternativë (OA) të ketë diferenca dhe këto janë të krahasueshme me tarifën operatorit dominant në treg. Tarifa e OA, mund të jetë më e vogël, por jo më e lartë se tarifa që aplikon operatori dominant Albtelecom në tregun ndërkombëtar.
2. Për pikën V, 6, gërma b, të Vendimit të AKEP, argumentohet se, tarifat që operatorët ndërkombëtarë (*carrier*) paguajnë terminimin e thirrjeve të tyre është shumë herë më e lartë (mbi 10 herë më e lartë) se tarifa e terminimit të thirrjeve kombëtare. Albtelecom për këto thirrje paguhet me çmimin e plotë ndërkombëtar dhe në këtë rast për rrugëzimin e thirrjeve ai duhet të përfitojë me të drejtë tarifën e tranzitimit, ndërsa pjesa tjetër e tarifës së paguar për terminim nga operatori ndërkombëtar i takon operatorit që terminon realisht. Këto janë segmentet e routimit të thirrjeve dhe secila palë duhet të marrë pjesën që i takon për segmentin e routimit për të cilën kontribuon në respekt të rregullave të reciprocitetit në një marrëdhënie komerciale.
 3. Për pikën V, 6, gërma d, paragrafet i, ii dhe iii, të Vendimit të AKEP, shprehen se, operatori marrës pëson humbje të mëdha financiare, kur thirrjet hyrëse ndërkombëtare nuk vijnë në rrjetin e tij direkt, por nëpërmjet Albtelecom, pasi:

i – tarifat e përcaktuara nga AKEP për OA janë më të larta se tarifat e terminimit respektiv për Albtelecom për terminimin në segment kombëtar. Vlera Z është e ndryshme edhe për rastin e terminimit në segment lokal/rajonar është 11% më e lartë (1.5 lekë kundrejt 1.34 lekë) ndërsa në rastin e terminimit në segment kombëtar është 10 % më e ulët. Pra si mesatare duket të jetë në favor të Albtelecom sepse shumica e lidhjeve të OA kanë qenë jo lokale/rajonale por kombëtare.

Y (tarifa për thirrjet hyrëse ndërkombëtare) përcaktohet nga operatori dominant i fushës (Albtelecom). Volumet e trafikut hyrës ndërkombëtar janë disa herë më të larta (mbi 10 herë) se trafiku hyrës ndërkombëtar për secilin OA.

ii – numrat e portuar tek operatori marrës janë rrjedhojë direkte e investimeve të bëra në treg dhe e faktit që OA ofron dicka më të mirë se sa operatori ‘incumbent’ dhe çdo OA ka investuar shumë në treg për të bërë të mundur portimin dhe mbajtjen e abonentëve në treg. Përfitimet si pasojë e portimit nuk mund të cilësohen si favor i operatorit marrës, për më tepër kur këto përfitime nuk janë të njëjta me shpenzimet e bëra për ta portuar numrin. Kjo është sfida e operatorit ‘new entry’ në treg dhe kostoja e thyerje së tregut monopol. Çdo argument i kundërt me sa më lart, synon të ruajë situatën monopol të tregut dhe është në kundërshtim me objektivitetin e portabilitetit të numrit dhe konkurrencën në shërbime, të operatorëve në treg.

iii – pozita dominante e Albtelecom në treg nuk është çënuar deri më sot nga procesi i portimit të numrave. Numrat e portuar nga Albtelecom drejt OA, për periudhën 15 mujore, janë 2% të pajtimtarëve të Albtelecom. Të

ardhurat që siguron Albtelecom nga thirrjet hyrëse ndërkombëtare, varen nga çmimi që vet Albtelecom përcakton në treg.

4. Sa më lart kane argumentuar sipërmarrësit ABCOM sh.p.k., SIN-TEL sh.p.k., TELE.Co Albania sh.p.k., SABATEL sh.p.k., dhe NISATEL sh.p.k, kërkohet nga AKEP, shfuqizimi i pikës 1/gërma a), nënpika 'c' dhe pikës 1/gërma b), nënpika 'c' të Vendimit nr. 2489, datë 26.6.2014, pasi cënon rëndë interesat financiare të tyre, dhe është i padrejtë e i pabazuar e nuk merr në konsideratë mënyrën reale të funksionimit të tregut.

II. AKEP pasi mori në shqyrtim ankimet administrstive të palëve të sipër përmendura dhe pretendimet e paraqitura gjykon se pretendimet e ngritura nga 5 operatorët ankimues janë adresuar dhe trajtuar qartë në VKD nr.2489 datë 26.06.2014, dhe nuk janë argumenta bindës për ndryshim të përcaktimeve të vendimit të ankimuar.

1. Për sa i takon pretendimeve në pikën 3/I më sipër për tarifat e terminimit të thirrjeve kombëtare, ato duhet të ishin trajtuar në kohën e vendimeve të AKEP për këto tarifa (Korrik 2013). Ndërkohë tarifa Y (tarifa që operatori marrës aplikon për thirrjet hyrëse ndërkombëtare në rrjetin e vet) përcaktohet nga operatori marrës dhe jo-nga Albtelecom. Kjo tarifë vjen përcaktohet nga një marrëdhënie komerciale ndërmjet operatorit marrës dhe operatorit nderkombëtar në një treg të de-rregulluar ku palët mund të negociojnë në bazë interesash komerciale.
2. Në lidhje me pretendimet në pikën 3/ii, dhe 3/iii më sipër AKEP ka dhënë sqarime të mjaftueshme në pikën V/6.d të vendimit nr.2489, datë 26.06.2014.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të rrëzojë ankimin administrativ të ABCOM sh.p.k., SIN-TEL sh.p.k, TELE.Co Albania sh.p.k, SABATEL sh.p.k., dhe NISATEL sh.p.k, ndaj Vendimit të AKEP nr. 2489, datë 26.6.2014, "Për disa ndyshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit të Albtelecom sh.a. në lidhje me thirrjet drejt numrave të portuar në rrejtet fikse"

2. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE